




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës (Komuna e Prishtinës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Si rezultat i planifikimeve buxhetore të gabuara komuna ka paguar 3,777,977€ nga investimet kapitale shpenzime që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve.
- A2 Saldo e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë në krahasim me vlerën e prezantuar në aneksin përcjellës të raportit financiar ishte nënvlerësuar për 1,975,3621€.
- B1 Komuna në regjistrin e pasurisë kontabël të SIMFK-së nuk kishte regjistruar 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim. Gjithashtu, në regjistrin e pasurisë kapitale nuk ishin regjistruar dy pagesa në vlerë 270,000€.
- A3 Prezantim jo i plotë i detyrimeve kontigjente në raportin vjetor financiar.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës nuk kanë qenë në përputhje me:

Baza për konkluzion

- A4 Dobësitë rreth përbërjes së anëtarëve të komisioneve të pranimit të punonjësve të shërbimit civil dhe shërbyesve publik.
- B2 Mos aplikimi i zbritjeve të nevojshme prej 15,000€ në vendbanimet parësore në regjistrin Protax të tatimit në pronë.
- A5 Procedurat e prokurimit publik nuk janë zhvilluar në të gjitha rastet sipas kërkesave të ligjit dhe rregullës së prokurimit publik.
- A6 Vlerësim jo i drejtë i ofertave dhe nënshkrim i kontratës publike pa zotim të mjeteve.
- B3 Parregullsi në pagesa dhe menaxhim të kontratave publike.
- B4 Subvencionimi i projekteve pa plan vjetor të mbështetjes financiare dhe jo në pajtim me kërkesat e rregullores qeveritare për financimin e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare (OJQ) dhe rregullores së brendshme të komunës. Gjithashtu, përbërja e anëtarëve të komisionit ishte në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- A7 Parregullsi në angazhimet e punonjësve përmes kontratave për punë dhe detyra specifike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prishtinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prishtinës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se sistemi i kontrollit të brendshëm në Komunën e Prishtinës nuk kishte funksionuar si duhet në shumicën e fushave të menaxhimit financiar. Fushat për përmirësim mbesin: prezantimi i informacionit financiar në raportin vjetor financiar duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese, planifikimi dhe realizimi buxhetor për investimet kapitale, klasifikimi i duhur shpenzimeve dhe pagesat përmes vendimeve gjyqësore, procesi i rekrutimit të personelit, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre, procedurat e prokurimit publik dhe menaxhimit të kontratave, procesi i subvencionimit, shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe pa kontrata, proceset në menaxhimin e tatimit në pronë dhe shqyrtimin e kërkesave për lejet ndërtimore, menaxhimi i pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme. Këto çështje janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve dhe kërkojnë veprime konkrete për të parandaluar dëme të mëtutjeshme të buxhetit të komunës.

Çështjet e ngritura dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me njëzet e dy (22) rekomandime, prej tyre trembëdhjetë (13) janë rekomandime të reja dhe nëntë (9) rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja	Me planin kontabël të thesarit janë përcaktuar kategoritë dhe kodet përkatëse ekonomike për llojet e shpenzimeve.
	Si rezultat i planifikimeve buxhetore në kategorinë jo përkatëse, nga buxheti për investime kapitale janë paguar 3,777,977€ shpenzime që për nga natyra nuk i takojnë investimeve kapitale, e që kryesisht kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe gjelbërimin e hapësirave publike, deratizimi dhe dezinfektimi hapësitor, operimi turistik, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve mjekësore etj. Po ashtu, keqklasifikim të shpenzimeve kishte edhe te investimet kapitale për vlerën 377,181€ që janë paguar për shërbimet kontraktuese të trafikut urban, e që i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.
	Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve buxhetore në kategoritë jo adekuate ekonomike, dhe mos pagesës së shpenzimeve nga buxheti i kategorisë përkatëse.
Ndikimi	Klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë jo përkatëse ndikon në pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.
Rekomandimi A1	Kryetari duhet të sigurojë se buxheti vjetor planifikohet në kategoritë përkatëse ekonomike, me tutje të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë

klasifikuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë në raportimet financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Prezantim i pasaktë i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Rregullorja MF-Nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për Organizata Buxhetore (OB), neni 16, ka përcaktuar që OB që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumatat e pa arkëtuara.

Në raportin vjetor financiar, nuk është prezantuar saktë saldo e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë. Saldo e tatimit në pronë sipas raportit të Protax që i është bashkëngjitur pasqyrave financiare është 37,679,403€, ndërsa sipas aneksit të pasqyrave financiare është prezantuar vlera 39,719,491€. Në raportin vjetor financiar, në tabelën për të arkëtueshmet, tatimi në pronë është prezantuar 37,744,130€, apo me një mbivlerësim prej 64,727€ nga vlera në raportin e Protax. Asnjëra nga vlerat e prezantuara nuk përputhen ndërmjet vete.

Si pasojë e menaxhimit të dobët të regjistrave të llogarive të arkëtueshme shpalosjet nuk janë prezantuar saktë në raportin vjetor financiar.

Ndikimi Shpalosjet e pasakta të llogarive të arkëtueshme, përveç ndikimit negativ që kanë në prezantimin e pasqyrave financiare, kjo edhe pamundëson informimin e drejtë financiar për Qeverinë dhe palët tjera të interesit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare të jenë të plota dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pronave në regjistrin kontabël të pasurisë

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, neni 6, pika 3, përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK.

Regjistrat e pasurisë jo financiare nuk prezantojnë vlerën e plotë dhe të saktë të pasurisë me të cilat disponon Komuna e Prishtinës. Komuna nuk ka arrit të regjistrojë në regjistrin e pasurisë kontabël të SIMFK-së pronat komunale, si janë 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim, ish-objektin e Gjykatës së Apelit, ish-objektin e Gjykatës Komunale, ndërtesat ku ndodhen drejtoria e inspektionit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si dhe tokën e shpronësuar për interes publik, Këto mangësi janë duke u përcjellë vit pas viti, dhe nuk është ndërmarr asnjë veprim në regjistrimin e tyre. Gjithashtu, dy pagesa të vitit 2021, në vlerë 270,000€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë.

Shkaku i dobësive të paraqitura ka të bëjë kryesisht me kontrollet joefikase në menaxhimin e pasurisë publike. Derisa nga ana e komunës, shkaqet qëndrojnë në mungesë të një komisioni profesional për vlerësimin e pasurisë.

Ndikimi Mangësitë aktuale në menaxhim dhe regjistrim të pasurisë jofinanciare, përveç efekteve negative që kanë në raportimin vjetor financiar, krijojnë edhe mundësi të humbjes apo keqpërdorimit të saj.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se pasuritë jofinanciare, pronat dhe objektet komunale vlerësohen dhe regjistrohen në regjistrin kontabël të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos prezantim i saktë i detyrimeve kontigjente në raportin vjetor financiar

Gjetja Me rregulloren nr.01/2017 për raportim vjetor financiar, neni 18 përcakton që OB në harmoni LMFPP-në raporton të gjitha detyrimet kontigjente në raportin vjetor financiar.

Komuna e Prishtinës nuk ka prezantuar saktë detyrimet kontigjente në raportin vjetor financiar. Sipas regjistrave të siguruar nga Komuna, vlera e përgjithshme e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2020 ishte 33,217,673€, ndërsa në vitin 2021 janë prezantuar vetëm 9,714,013€. Sipas këtyre të dhënave, rezulton se saldo e detyrimeve kontigjente në vitin 2021 rezulton me një diferencë prej 23,503,660€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka shpalosur vetëm detyrimet aktive në periudhën e raportuar, përkatësisht lëndët apo rastet të cilat janë në trajtim nga gjykata në vitin 2021, por jo edhe kontestet tjera të cilat nuk ishin shqyrtuar.

Ndikimi Prezantimi i pasaktë i detyrimeve kontigjente nuk tregon pasqyrim të drejtë të vlerës së tyre në PFV për palët e interesit. Njëkohësisht, kjo ndikon që komuna të mos jetë në gjendje të parashikojë dhe të bëjë planifikimet e duhura të buxhetit e cila kushtimisht mund të ndikohet nga lëndët që janë në konteste gjyqësore, pavarësisht trajtimit të tyre në kohë. Si pasojë, përfundimi i kontesteve gjyqësore në dobi të pretenduesve do të shkaktojë kosto financiare dhe implikime buxhetore për komunën.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin vjetor financiar, duhet të jenë të plota, pavarësisht se në cilën fazë të shqyrtimit nga autoritetet përkatëse janë ato, deri në marrjen e një vendimi final nga organet kompetente.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Dobësitë në formimin e komisioneve të pranimit të punonjësve

Gjetja

Me ligjin nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, neni 34, pika 12, si dhe nenin 68, pika 7, kanë përcaktuar nivelet, cilësitë dhe kriteret që duhet të kenë anëtarët e komisioneve të pranimit të punonjësve, si dhe të jenë profesionistë të fushës në të cilën bëhet vlerësimi i kandidatëve. Me ligjin nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, neni 26, pika 12, përcakton që auditorët e brendshëm nuk përfshihen në realizimin e funksioneve të drejtpërdrejta të subjektit të sektorit publik. Gjithashtu Rregullorja QRK nr.01/2019, neni 9, pika 3, përcakton që Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka pavarësi funksionale për të planifikuar, kryer dhe raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe nuk kryen detyra të tjera në kuadër të subjektit të sektorit publik që nuk lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm.

Komisioni i pranimit për punonjësit e Shërbimit Civil (SHC) nuk ishte themeluar sipas kërkesave ligjore. Anëtar i komisionit ishte caktuar udhëheqësi i auditimit të brendshëm, të cilit me ligj nuk i lejohet të përfshihet në realizimin e funksioneve të drejtpërdrejta të subjektit të sektorit publik, një zyrtar i kategorisë profesionale e që nëpunësit e kësaj kategorie nuk lejohet të jenë pjesë e komisioneve, dhe një anëtare e jashtme për të cilën në komunë janë deklaruar që është nga shoqëria civile. Ligji për zyrtarët publik (LZP) ka përcaktuar që personat nga shoqëria civile mund të angazhohen vetëm në cilësinë e vëzhguesit. Në komision të pranimit nuk ishin angazhuar ekspert të jashtëm nga organizata të specializuara apo universitetet, dhe as anëtar të sindikatës në cilësinë e vëzhguesit.

Në komisionet e pranimit për shërbyesit publik, mësimdhënës të mësimin klasor dhe edukatore, si dhe për mësimdhënës të gjuhës shqipe, gjermane dhe angleze, nuk kishte përfaqësues nga Njësia e Burimeve Njerëzore (NjBNj), ndërsa 3 anëtarë tjerë nuk ishin profesionistë të fushës në të cilën bëhej vlerësimi i kandidatëve, por nga fusha tjera si nga administrata, buxhet, sporti dhe zyra e komuniteteve. Në komisionin e pranimit nuk ishte caktuar askush nga personeli arsimor i nivelit menaxhues.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos gatishmërisë së menaxhmentit për formimin e komisioneve të pranimit sipas kërkesave ligjore. Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm kishte kërkuar nga Kryetari i Komunës që ta ndryshojë vendimin dhe ta largojë nga komisioni i pranimit të shërbyesve civil dhe lëvizjeve brenda kategorisë, por vendimi nuk ishte ndryshuar.

Ndikimi

Përbërja joadekuarte e komisioneve të pranimit dhe mungesa e cilësive dhe kompetencës profesionale të anëtarëve të komisionit mund të ndikojë në përzgjedhjen e kandidatëve jo meritore.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se përbërja e anëtarëve të komisioneve të pranimit për nëpunësit e SHC dhe shërbyesve publik të jetë në përputhje me pozitën, cilësitë dhe kriteret e përcaktuara me nenin 34 dhe 68 të LZP. Gjithashtu, auditorët e brendshëm të mos jenë pjesë e komisioneve të pranimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Parregullsi në faturimin e tatimit në pronë

Gjetja Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme - zbritja për vendbanimin parësor- përcakton që “Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit”.

Nga mostrat e testuara është gjetur se në dy (2) raste komuna ka lejuar zbritjet prej 15,000€ për vendbanime parësore, për dy a më shumë prona në pronësi të një tatimpaguesi, dhe kjo ka ndikuar në nënvlerësim të tatimit në pronë. Bazuar në të dhënat e raportit nga Protax, është konstatuar se edhe në 123 prona/objekte është aplikuar zbritja e parregullt në emër të vendbanimit parësor prej 15,000€, dhe kjo situatë ka shkaktuar nënvlerësim të tatimit rreth 11,300€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos vlerësimit (ri-anketimit) gjatë fazës së inspektimit nga ana e anketuesve në teren, si dhe vështirësitë /gabimet që kanë rrjedhur nga sistemi Protax. Departamenti i tatimit në pronë në MF ishte njoftuar nga zyrtarët komunal për gabimet.

Ndikimi Mos aplikimi i drejtë i zbritjeve për vendbanimet parësore ka ndikuar në nënvlerësim/mbivlerësimi të tatimit në pronë, përkatësisht ka lehtësuar/ngarkuar barrën tatimore për tatimpaguesit. Komuna mund të jetë subjekt i padive nga tatimpaguesit, për shkak të ngarkesave të parregullta tatimore.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inspektimit/verifikimit të pronave bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu duhet të siguroj se politikat e komunikimit me tatimpaguesit janë duke funksionuar me qëllim të përditësimit të bazës me të dhëna të sakta sa i përket aplikimit/mos aplikimit të zbritjeve të lejuar sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Parregullsi në procedurat e prokurimit publik dhe përzgjedhje e ofertuesit të papërgjegjshëm**

Gjetja Sipas RRUOP, pika 41.2, procedura e vlerësimit të tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Në njoftimin për kontratë, si kusht për pjesëmarrje është kërkuar përmbushja e kërkesave të përshtatshmërisë, përkatësisht ofrimi i dëshmisë se kompania nuk është në falimentim ose në administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata - kërkohet dokumenti origjinal vetëm nga OE që shpërblehet me kontratë.

Te kontrata publike kornizë Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në vlerë indikative 406,383€, grupi i operatorëve ekonomik i kontraktuar nuk e ka plotësuar kërkesën e pranueshmërisë të specifikuarë në nenin 65, të Ligjit nr. 04//L-042 për prokurimin publik. Njëri nga anëtarët e konzorciumit nuk ka sjellë dëshmitë origjinale apo të noterizuar nga gjykata që dëshmon se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor, dhe se ka paguar detyrimet tatimore. I njëjti ka sjellë një dokument të noterizuar nga kopja e zakonshme, jo nga dokumenti origjinal. Noteri në shkresë deklaroi se dokumenti i noterizuar përputhet me kopjen e zakonshme, dhe se noterit nuk i është prezantuar dokumenti origjinal. Vlerësimi i tenderëve për këtë procedurë tenderimi kishte zgjatur më shumë se 45 ditë nga hapja e tenderëve, dhe për këtë nuk kishte kërkesë nga komisioni për afat shtesë. Edhe te kontrata për Furnizim me lëndë djegëse pellet për shkollat fillore dhe të mesme, vlerësimi i tenderëve kishte zgjatur 77 ditë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontroleve të pamjaftueshme në procedurat e prokurimit dhe vlerësim të ofertave.

Ndikimi

Kontraktuesit mund të mos jenë të përgjegjshëm në realizim të projektit, dhe se vonesat në vlerësim të ofertave kanë ndikim negativ në realizim të objektivave dhe planifikimeve operacionale.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe mundësitë e përcaktuara me ligjin e prokurimit me qëllim që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike dhe efikase. Vlerësimi i tenderëve të realizohet brenda afatit 30 ditor, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë të zgjatet për një afat shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Vlerësim jo i drejtë i ofertave dhe nënshkrim i kontratës pa zotim të mjeteve në SIMFK

Gjetja

Neni 69 i LPP përcakton që Autoriteti Kontraktues (AK) mund të kërkojë nga ofertuesit të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Pika 39.8 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP), shpjegon që mund të kërkojnë informata sqaruese nëse mungon çertifikata ose raporti i punëve të kryera.

Neni 36.1 i ligjit 05/L-063 LMFPP, përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, OB i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK.

Te procedura e prokurimit Operimi turistik, komisioni i vlerësimit ka eliminuar ofertuesin me çmimin më të lirë 23.56€ (çmimi i peshuar) dhe ka përzgjedhur ofertuesin që ka ofruar çmimin 48.69€. Eliminimi i ofertuesit më të lirë ishte bërë me arsyen se nuk i ka bashkangjitur listës për realizimin e kontratave të ngjashme edhe referencat për punët e kryera. Ofertuesi kishte ofruar informacion për kontratat e ngjashme sipas listës së paraparë me aneksin 6 të dosjes së tenderit. Ndonëse OE i eliminuar kishte ofruar çmim përgjysmë më të lirë, dhe me qëllim që fondet publike të përdoren në

mënyrën më ekonomike, komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar informacione shtesë lidhur me referencat ose çertifikatat për kryerjen e shërbimeve. Vlera e kontratës publike është 80,000€, dhe se nënshkrimi i kontratës është bërë pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore në SIMFK.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të pamjaftueshme në vlerësim të ofertave dhe nënshkrim të kontratave.

Ndikimi Mos zbatimi i kërkesave ligjore të prokurimit publik i ka shkaktuar komunës humbje përkatësisht kosto me të lartë financiare.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit zbatojnë kërkesat e përcaktuara me rregullën dhe udhëzuesin e prokurimit publik për kërkimin e informatave sqaruese në rastet përkatëse. Gjithashtu të sigurohet se para nënshkrimit të kontratës publike mjetet financiare të zotohen në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Parregullsi në pagesa dhe menaxhim të kontratave publike

Gjetja RrUOPP, pika 56.10, përcakton që kurdo që AK specifikon sasinë indikative, AK do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se +/- 30%, dhe kjo vlen edhe për lote dhe për pozicion apo artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi të tjera.

Me kontratën publike kornizë për Pastrimin e objekteve të Komunës së Prishtinës, me vlerë të parashikuar prej 535,374€, në specifikacionin e çmimeve, në pozicionin 1 pastrimi i hapësirave të brendshme ishin kontraktuar 21,667.83 m², ndërsa në pozicionin 11 Objekte tjera komunale sipas nevojës që parashtrihen, ishin kontraktuar 4,000m² me çmim total 2,500.52€, apo 0.63€/m².

Pas fillimit të realizimit të kontratës, janë bërë dy amandamente të kontratës bazë për shkak të korigjimeve të hapësirave dhe shtimit të objekteve tjera për pastrim. Sasia e korigjuar e hapësirave të brendshme ishte 15,377.69 m², ndërsa lejimet për ndryshim nuk duhej të tejkalonin sasinë prej 6,500m², duke tejkaluar limitin e lejuar nga 30% në 71%. Ndërsa për hapësirat shtesë, 14,286,69m² janë kalkuluar me çmim prej 0,70€, në vend të çmimit 0,63€. Marrë për bazë çmimin e aplikuar në raport me çmimin e kontraktuar, del se mbipagesa mujore është 1,143€, ndërsa për afatin 36 mujor të kontratës, mbipagesat do të jenë 41,146€.

Te pagesa për projektin “Rikonstruimi i rrugës Haxhi Zeka krahu 1,2,3” në vlerë 140,432€, pozicioni 1.7 demolimi i gurëve skajor ekzistues me dim 18x24 dhe materialeve tjera të ngurta duke përfshirë edhe transportin, sasia e kontraktuar ka qenë 749m, ndërsa sipas situacionit për punët e kryera ishte 1,304m.

Te kontrata për Furnizim me rrobalarëse, rrobatharëse dhe enëlarëse për institucionet parashkollore në vlerë 7,560€, urdhërblerja, porosia dhe pranimiti i paisjeve ishte bërë një muaj pas skadimit të kontratës. Vonesa në zotim të mjeteve financiare në SIMFK dhe përgatitje të urdhërblërjeve janë

hasur edhe në 11 raste tjera.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të mangëta në menaxhimin e kontratave dhe mos zbatimin e kërkesave të ligjit të prokurimit publik lidhur me kontratat publike kornizë.

Ndikimi

Mos veprimi sipas kushteve kontraktuale ka ndikuar në kosto shtesë financiare për buxhetin e Komunës. Urdhërblertjet dhe zotimet e mjeteve me vonesë ndikojnë negativisht në realizim buxhetor si dhe krijojnë mundësi për padi nga kontraktuesit në rastet e mospagesës me kohë të obligimeve.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike kornizë zbatohen sipas kushteve dhe çmimeve kontraktuale. Në rastet kur paraqiten nevojat për amandamentim të kontratës publike, ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore, rregullën dhe udhëzuesin për prokurimin publik, duke mos tejkaluar pragun e lejuar prej 30%.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mosrespektim i rregullave për mbështetje financiare

Gjetja

Me Rregulloren MF. nr. 04/2017, neni 6, përcakton që ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM-së, neni 7, përcaktohet që se ofruesi i mbështetjes financiare duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës për secilën kontratë, ndërsa neni 8, pika 7, përcakton që anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik. Rregulloren e komunës për ndarjen e subvencioneve, me nenin 6, pika 6.2, është përcaktuar që personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga komuna.

Komuna gjatë vitit 2021 ka ndarë nga dy herë subvencione në fushën e sportit për 62 persona juridik (OJQ) dhe persona fizik, ndërsa një përfitues ishte subvencionuar 3 herë. Ne fazën e parë për këta përfitues ishin ndarë 158,706€, ndërsa për fazën e dytë 189,161€.

Te procesi i vlerësimit të kërkesave për subvencionim “*Përkrahje për media*”, dy anëtar të komisionit për vlerësim të kërkesave ishin nga stafi politik. Pagesat për tre përfitues në vlerë totale 10,350€ ishin pa kërkesë të arsyetuar, pa marrëveshje, nuk është caktuar zyrtari për monitorim dhe nuk janë dorëzuar raporte kthyesë nga përfituesit.

Te kontrata “Furnizimi me kultivator për fermer” në vlerë prej 57,750€, zyrtari që ka qenë anëtari i komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në sektorin e bujqësisë ishte emëruar edhe menaxher i kontratës.

“Kuzhina qendrore” subvencionohet me vendim të Kuvendit në vlerë prej 30,000€ pa kërkesë të arsyetuar, pa marrëveshje dhe nuk ka aplikuar raporte kthyesë.

Komuna nuk e ka mbështetur me planifikim konkret dhënien e subvencioneve, kjo për shkak se nuk ka përgatitur Planin vjetor të mbështetjes financiare

për OJQ-të. Komuna nuk ka përgatitur as Raportin vjetor për projektet e financuara.

Kjo ka ndodhur shkak i mungesës së kontrolleve të brendshme në zyrën e kryetarit dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për subvencionim.

Ndikimi Mungesa e planeve vjetore pamundëson informimin paraprak të palëve të interesit dhe OJQ-ve. Mos respektimi i rregullave për mbështetjes financiare rritë mundësin që të ketë trajtim jo të barabartë të përfituesve. Projektet mund të mos zbatohen në mungesë të monitorimit dhe raportimit nga përfituesit.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se anëtar të komisionit të vlerësimit të kërkesave të mos jenë stafi politik. Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ dhe Raporti vjetor të përgatiten dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM). Për projektet e subvencionuara të caktohen monitoruesit dhe të kërkohen raporte kthyesë financiare dhe narrative nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Angazhimet e punonjësve përmes kontratave për punë dhe detyra specifike

Gjetja Ligji i punës nr. 03/L-212, neni 8, përcakton që punëdhënësi në sektorin publik është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie pune. Me neni 10, pika 6, specifikohet që kontrata për punës dhe detyra specifike (KPDS), nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë brenda një (1) viti.

Komuna e Prishtinës nuk disponon me një regjistër të plotë dhe të saktë të punonjësve të angazhuar përmes KPDS. Bazuar në listat mujore të deklarimit të tatimeve dhe kontributeve pensionale në ATK, gjatë vitit ishin angazhuar deri 168 punonjës përmes KPDS, pa aplikuar procedura të rregullta të rekrutimit. Pas skadimit të kontratave të para 4 mujore, janë përsëritur vazhdimisht kontratat e radhës me nga 4 muaj.

Nga 4 mostra të testuara, është gjetur se dy të punësuarit fillimisht ishin angazhuar përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV) që nga viti 2019 dhe 2020, dhe pas ndalimit të vazhdimet të MSHV me ligjin e zyrtarëve publik, të njëjtat janë zëvendësuar me KPDS. Ndërsa te dy rastet tjera, kontratat e punës ishin përsëritur vazhdimisht pas skadimit të afatit 4 mujor. Ndonëse këto kontrata aplikohen për punë dhe detyra specifike, punonjësit janë angazhuar për pozita të rregullta të punës, si zyrtar administrativ, mësimdhënës, zyrtar për urbanizëm, zyrtar për planifikim, zyrtar për ndërtimtari, etj. Pagesat mujore për këta të punësuar janë realizuar nga buxheti i mallrave dhe shpenzimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me angazhimin e punonjësve me shërbime të veçanta dhe kërkesave në zbatimin e ligjit të punës.

Ndikimi Angazhimi i punonjësve përmes kontratave për punë dhe detyra specifike kryesisht për punë dhe detyra të rregullta ndikon negativisht si në aspektin

buxhetor ashtu edhe në aspektin e aktiviteteve operative.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i punonjësve përmes kontratave për punë dhe detyra specifike të aplikohet vetëm në rastet për punë dhe detyra që kanë natyrë të veçantë, e jo për pozita të rregullta të punës. Afati kohor i llojit të tillë të kontratave të mos tejkalojë 120 ditë brenda një viti.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës në 2021 ishin në vlerë 35,436,252€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për lejet e ndërtimit, shfrytëzimi i pronës publike, taksat administrative, participimet, taksat për ushtrimin e veprimtarisë, të hyrat nga qiraja etj. Përveç kësaj shume, të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat nga gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve ishin në vlerë totale 2,735,073€ të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) dhe Agjencioni i Pyjeve (AP), të cilat i alokohen Komunës së Prishtinës për shpenzim. Për vitin 2021, komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë totale 28,271,947€, dhe tejkalimi i planit për 7,164,305€ kryesisht rrjedhë nga pagesat e shtuara të tatimit në pronë, për shkak të shtyrjes së pagesave nga viti paraprak për shkaqe të pandemisë, dhe lejeve ndërtimore me rritjen e aktiviteteve. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i realizimit të të hyrave të këtij vitit është rritur rreth 42%, apo për 10,465,387€ më shumë. Rritja kryesisht ka të bëjë me tatimin në pronë dhe taksat nga lejet ndërtimore.

Çështja B5 - Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara

Gjetja

Sipas nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, sipas “Statutit të komunës neni 33.2- a, dhe Ligjit 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës vihet në pah mundësia/mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale”.

Në vitin 2014 komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat në “Zonën Industriale”. Të paktën 37 parcela të kësaj zone me rreth 6 ha, shfrytëzohen nga biznese private pa asnjë kompensim ndaj Komunës, duke shkaktuar humbje financiare për buxhetin e komunës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal, në vitin 2007 ishin dhënë me qira 21 banesa për ish këshilltarët komunal. Gjithashtu, në vitin 2008, me vendim të komisionit për çështje banesore, ishin dhënë edhe 22 banesa tjera me qira për punëtorët administrativ. Nga testimi i 3 mostrave/kontratave për qiradhënie, ku afati i shfrytëzimit ishte për periudhën 10 vjeçare përkatësisht deri më 2017/2018, përkundër që kontratat nuk janë vazhduar, qiramarrësit vazhdojnë shfrytëzimin e banesave/pronën publike. Përveç kësaj, edhe pse kompensimi për shfrytëzim ishte minimal (0,30€/m²), pagesat e qirasë nuk ishin bërë me kohë të rregullt, dhe borxhet e akumuluar ndër vite janë 11,733€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve adekuate dhe mos veprimit të menaxhmentit për trajtimin e kësaj çështje, me gjithë rekomandimet e përsëritura në vazhdimësi.

Ndikimi

Mungesa apo edhe skadimi i kontratave për shfrytëzim të pronës, e vendosë komunën në situatë të vështirë për realizimin e të hyrave, por edhe për ndjekur procedura gjyqësore/përmbartimore për llogarit e pa arkëtuara. Komuna nuk ka arritur ta trajtojë këtë çështje për vite me radhë edhe përkundër zotimeve me planet e veprimit. Kjo situatë ka krijuar hapësirë që këto prona të keqmenaxhohen dhe keqpërdoren nga shfrytëzuesit.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet ti përmbahet zotimeve sipas planit të veprimit të përgatitur nga vet komuna që çështja e këtyre pronave të zgjidhet duke përdorur të gjitha mundësit ligjore. Të siguroj se pronat komunale shfrytëzohen vetëm përmes kontratave valide, dhe marrjen e veprimeve konkrete në inkasimin e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për pajisje me leje të ndërtimit dhe leje mjedisore

Gjetja Neni 17 pika 1.2, e Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110, përcakton që "Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III". Po ashtu, sipas nenit 11 të UA nr. 01-2017- Për dhënien e lejeve mjedisore komunale: "Vendimi për miratim ose refuzim të LMK-se i nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë përkatëse, lëshohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës".

Komuna nuk ka respektuar afatet ligjore për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Në nëntë (9) raste për lejet ndërtimore, kemi identifikuar se vonesat në shqyrtimin e kërkesave ishin prej një (1) deri 19 muaj. Edhe në lëshimin e lejeve mjedisore kishte vonesë deri në 8 muaj.

Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhur si pasojë e numrit të lartë të kërkesave dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore brenda drejtorisë së planifikimit strategjik (e sidomos sektori për lëshimi e lejeve mjedisore komunale) dhe drejtorisë së urbanizmit për shqyrtimin e kërkesave me kohë.

Ndikimi Shqyrtimi i kërkesave me vonesë nga autoritetet komunale ndikon në arkëtimin e vonuar/shtyrë të të hyrave, që burojnë nga këto shërbime, për shkak të vonesave nga zyrtarët kompetent, në ofrimin e këtij shërbimi që paguhet nga aplikuesit.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet sigurojë se kërkesat për leje ndërtimore dhe mjedisit të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore. Të analizohen rastet e mungesave të kapaciteteve njerëzore dhe të shqyrtohen mundësit për zgjidhjen e kësaj çështje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga e Mëditje ishte 31,449,882€ derisa janë shpenzuar 31,448,160€, apo 99.99%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 4,742 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 4,657, pa i përfshirë anëtarët e kuvendit komunal. Gjatë vitit 2021 ishin punësuar tetë (8) nëpunës të shërbimit civil, dhe 301 nëpunës të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë, artit dhe në sektorin arsimit (përfshirë edhe zëvendësimet në institucionet shkollore).

Çështja A8 - Dobësitë në procedurat e rekrutimit të personelit në shërbimin civil

Gjetja Rregullorja (QRK) nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në SHC, kapitulli II dhe IV me nenet 40 deri 64, përcaktojnë kushtet dhe kërkesat, komisionet e pranimi dhe aspektet tjera të konkurrimit për pranim, lëvizjet brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë.

Në konkurset për lëvizje brenda kategorisë, për pozitat udhëheqës i sektorit për arsim dhe zyrtar i lartë i personelit, nuk ishin kërkuar kualifikimet universitare siç kërkohet me katalogun e vendeve të punës në SHC, por ishin kërkuar kualifikimet universitare që i posedonin të punësuarit. Për pozitën udhëheqës i sektorit të arsimit, sipas katalogut kërkohet që kandidati të ketë diplomë universitare në drejtimin e edukimit, ndërsa me konkurs ishte kërkuar diplomë në drejtimin juridik apo ekonomik. Te pozita zyrtar i lartë i personelit, sipas katalogut kërkohet që kandidati të ketë diplomë në drejtimin e burimeve njerëzore ose juridik, ndërsa me konkurs është kërkuar vetëm drejtimi juridik. Të përzgjedhurit nuk posedonin përvojën profesionale në fushat përkatëse siç kërkohet me katalogun e vendeve të punës. Në dosje mungonin formularët e intervistimit.

Për pozitën udhëheqës i sektorit të arsimit, kishte aplikuar vetëm një kandidatë dhe konkursi nuk ishte vazhduar edhe për 10 ditë tjera kalendarike, siç kërkohet me nenin 44, pika 3, dhe nenin nenin 13, pika 2, e Rregullores (QRK) nr.16/2020, ku përcaktohet që nëse numri i aplikacioneve të pranuar është më i vogël ose i barabartë se sa numri i pozitave të lira për të cilat zhvillohet procedura e konkurrimit, afati për aplikim vazhdohet edhe për dhjetë (10) ditë kalendarike. Anëtarët e komisionit të pranimi nuk kishin pozita të punës më të larta se sa pozita që rekrutohet, nuk ishin të specializuar në fushën përkatëse për të cilën zhvillohet konkurrimi, por nga fusha e sportit, rendit komunal, planifikim, dhe se anëtar i komisionit nuk ishte mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Në konkursin për ngritje në detyrë për pozitën Udhëheqës i sektorit të shëndetësisë, i punësuarit nuk kishte plotësuar kriterin e konkursit dhe kërkesat ligjore që të ketë së paku 3 vite në kategorinë më të ulët për ngritje në detyrë. I përzgjedhuri kishte vetëm një (1) vit pune në SHC. Në dosjen e rekrutimit mungonte kërkesa nga njësia kërkuese për plotësimin e vendit të punës, miratimi nga udhëheqësi më i lartë administrativ, si dhe formularët e intervistimit. Asnjëri nga anëtarët e komisionit pranues nuk kishte pozitë të lartë drejtuese, siç kërkohet me neni 59 të rregullores (QRK) nr.16/2020.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mos zbatimit të rregullores për procedurat e rekrutimit, lëvizjes dhe ngritjes në detyrë nga menaxhmenti dhe komisioni për pranim.

Ndikimi Çështjet e paraqitura më lartë, mund të ndikojnë në mos përzgjedhjen

adekuate të kandidatëve, si dhe në objektivat dhe detyrat e punës.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të sigurojë se përzgjedhja e kandidatëve të bëhet në mënyrë transparente, konkurruese dhe në bazë të meritës. Komisionet e vlerësimit të jenë në përbërje sipas kriterëve të përcaktuara, dhe që me rastin e vlerësimit të zbatojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Parregullsi në procedurat e rekrutimit për punonjësit e shërbimit publik

Gjetja

Ligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, neni 67, përcakton që themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të shërbimit publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik të hapur, të organizuar sipas këtij ligji. Sipas nenit 68, hapja e procedurës së konkurrimit zhvillohet përmes ueb faqes e konkurrimeve të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj).

Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit për mësimdhënës në institucionet arsimore nuk janë zhvilluar përmes SIMBNJ-së. Në konkurset publike për mësimdhënës në institucionet arsimore, ishte përcaktuar si kriter që vlerësimi i njohurive profesionale do të vlerësohet deri 40 pikë (ku përfshihet përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve). Komisionet e vlerësimit nuk kanë vepruar sipas kriterit të përcaktuar me konkurs, duke mos marrë për bazë përvojën e punës së kandidatëve. Nuk kishte dokument vlerësimi matematikor në kalkulimin e pikëve për përvojën e punës dhe kualifikimit profesional të kandidatëve.

Nga auditimi i katër (4) procedurave të rekrutimit të mësimdhënësve⁴, është gjetur se:

- në një rast aplikacioni për punësim nuk ishte i nënshkruar nga kandidatja e punësuar;
- në dy raste kandidatët nuk kishin përvojë pune dhe ishin vlerësuar me pikë të larta duke hyrë në grupin e kandidatëve të përzgjedhur;
- në një rast kandidatja ishte vlerësuar me 50 pikë të kriterit të njohurive profesionale që maksimumi për këtë kriter ishte 40 pikë duke e mbivlerësuar për 10 pikë;
- në një rast mungonte vlerësimi i kandidatit nga njëri anëtar i komisionit, ndërsa në dy raste procesverbali i intervistës nga kryetarin të komisionit ishte i panënshkruar;
- e punësuar që kishte aplikuar për pozitën edukatore për parafillor, kontrata e punës i është bërë për pozitën edukatore, edhe pse ishin pozita të ndara me konkurs.

E punësuar në pozitën mësimdhënëse për ekonomi dhe ndërmarrësi, e angazhuar me kontratë për punë dhe detyra specifike dhe pa u zhvilluar ndonjë procedurë e rekrutimit, një muaj pas punësimit i është ndryshuar qëllimi apo objekti i kontratës duke i deleguar detyra tjera dhe emëruar përkohësisht në pozitën e drejtorit të shkollës. Ndryshimi i objektit të kontratës (puna dhe detyra specifike) dhe tejkalmimi i afatit të saj në aspektin kohor të kohëzgjatjes, nuk paraqet bazë juridike për dhënien e detyrave tjera që tejkalojnë detyrat e përcaktuara me kontratën bazë e edhe afatin e zbatimit të saj. KPDS aplikohet vetëm për rastet e veçanta dhe specifike, por jo edhe për pozitat që kanë natyrë të rregullt të punës. Emërimi i përkohshëm në pozitën e drejtorit të shkollës zbatohet për punëtoret e

arsimit me kontrata të rregullta të punës, siç edhe përcakton Rregullorja nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendës drejtorit në institucionet edukative-arsimore.

Konkursi për pozitën Shef i administratës dhe personelit në Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU), nuk ishte zhvilluar përmes SIMBNj-së, por ishte shpallur konkurs i brendshëm në ueb faqen e komunës. Pozita e lirë e punës i takonte kategorisë së nëpunësve të shërbimit publik, përderisa e punësuar ishte nëpunëse e SHC dhe nuk ishte pjesë e personelit të QMU-së. Në komisionin përzgjedhës të kandidatëve nuk kishte përfaqësues nga NjBNj, ndërsa tre anëtar tjerë kishin pozita të punës më të ulëta se pozita e shpallur me konkurs.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme për procedurat e rekrutimit nga menaxhmenti.

Ndikimi

Parregullsitë e identifikuar kanë pamundësuar një zhvillim të rregullt, objektiv dhe konkurrues të procesit të rekrutimit, dhe mund të ndikojë në përzgjedhjen e kandidatëve potencial.

Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë se përzgjedhja e kandidatëve bëhet në mënyrë transparente, konkurruese dhe në bazë të meritës. Anëtarët e komisionit të zbatojnë kriteret e konkursit në mënyrë që të arrihen rezultatet konkurruese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre

Gjetja

Neni 83, pika 10 e ligjit 06/L-114 për zyrtarët publik, përcakton që me hyrjen në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës (UD) kthehen në vendin punës.

Menaxhmenti nuk ka arritë që për pozitat e mbajtura me UD të zhvillojë procedura përzgjedhëse për personel me kontrata të rregullta. Sipas të dhënave të Komunës, 32 pozita pune ishin me UD, pa përfshirë UD në sektorin e arsimit (drejtor, zëvendës drejtor, sekretar) për të cilët nuk kanë ofruar informata nga zyra e personelit. Nga tre (3) mostra të audituara është identifikuar se pozitat mbaheshin me UD për kohë të gjatë. Pozitat e punës shef i sektorit të jashtëm të arkivit komunal dhe udhëheqës i sektorit për menaxhim të kontratave për ndërtim të ulët ishin me UD që nga viti 2016.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve dhe mos gatishmërisë së menaxhmentit për plotësimin e pozitave të punës me personel përmes kontratave të rregullta.

Ndikimi

Mbajtja e pozitave të punës me UD mund të ndikojë në mos përkushtimin e duhur të personelit në menaxhimin e punëve.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të sigurojë që pozitat e punës të mbajtura me ushtrues të detyrës të plotësohen me punonjës me kontrata të rregullta të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Mungesa e autorizimeve për realizimin e punëve dhe orëve shtesë

Gjetja Me rregulloren nr. 33/2012 për shtesat ne pagë dhe kompensime te tjera, neni11, përcakton që nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orarit, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit.

Nuk është bërë autorizimi paraprak i punës dhe orëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Nga lista mujore e kompensimeve të muajit dhjetor 2021, në vlerë totale 11,331€, janë testuar 3 raste⁵ të kompensimeve në vlerë 1.788€, ku përveç një raporti përmbledhës për pagesë mujore, nuk kishte evidencë analitike që dëshmon se në cilat ditë apo data, dhe nga sa orë është punuar jashtë orarit apo gjatë vikendeve. Punët për të cilat janë paguar kompensime shtesë janë punë të cilat pritet të kryhen gjatë orarit të rregullt të punës, siç janë punët lidhur me menaxhimin e personelit dhe aktivitetet e rregullta të procesit te prokurimit.

Shkak i kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme në autorizimin dhe mbikëqyrjen e orëve shtesë.

Ndikimi Mungesa e autorizimeve paraprake nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk siguron dhe nuk arsyeton nevojën e punëve dhe pagesave shtesë dhe krijon shpenzime shtesë për komunën.

Rekomandimi A11 Kryetari duhet të sigurojë se punët shtesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë arsyetuar dhe autorizuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se mbahet evidencë për orët dhe ditët e angazhimeve në punët shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 51,151,336€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 17,410,321€. Ato kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturën rrugore, ndërtimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, furnizim me paisje, vetura shëndetësore, etj.

Çështja B7 - Mangësitë në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Njësitë kërkuese duhet të analizojnë dhe përgatisin specifikacionin teknik, përkatësisht paramasën dhe parallogarin për projektet kapitale që planifikohet të realizohen. Me kontratën publike të nënshkruar mes komunës dhe kontraktuesit, përcaktohen kushtet kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Si rezultat i planifikimeve joadekuate, punimet për projektin “Rikonstruimi i Rrugës Isa Kastrati” kishin vështirësi në realizimin për faktin se komuna nuk ka mundur t’i zgjidh problemet pronësore-juridike të parcelave ku kalon kjo rrugë. Në paramasë dhe parallogari ishte planifikuar edhe pozicioni i shiritit të biçikletave, por ky pozicion nuk është realizuar shkaku i mos shpronësimit të parcelës për të liruar hapësirën.

Punimet në projektin “Ndërtimi i parkut rekreativo - sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” janë përcjellë me pengesa për shkak të punimeve nga Ngrohtorja e qytetit Termokos, dhe nga kërkesat e shumta të qytetarëve për ndryshim të projektit. Në paramasë është planifikuar edhe pozicioni për Skybord, mirëpo nuk është realizuar shkaku i peticionit të banorëve për mos realizimin e saj për shkak se kjo mund të shkaktojë zhurmë.

Gjithashtu për shkak të planifikimeve dhe menaxhimit joadekuat të kontratave kishte edhe vonesa në realizim të punimeve. Projekti për “Ndërtimi i parqeve rekreativo sportive në kryeqytet” në vlerë 336,436€, i filluar në shator 2020, ishte planifikuar të realizohej për 120 ditë kalendarike. Në fund të vitit 2021, menaxheri dhe mbikëqyrësi i kontratës informojnë se arsyet për tejkalim të planit dinamik janë kryesisht për shkak të mangësive dhe gabimeve në projekt, të cilat kanë marrë kohë për tu përmirësuar. Punët në implementimin e projektit po zhvilloheshin në vonesë për më shumë se një (1) vit.

Sipas marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit “Hartimi i planit zhvillimor dhe hartimi i hartës zonale”, projekti duhet të përfundonte në prill të vitit 2021, ndërsa projekti ishte në vonesë të realizimit prej shtatë (7) muajve. Projekti “Rikonstruimi i Rrugës Isa Kastrati” në vlerë 349,737€, ishte planifikuar të realizohej brenda 60 ditëve kalendarike, derisa punimet kishin zgjatur 169 ditë.

Te pagesa “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” në vlerë 96,000€, ndryshon trasea e rrugës sidomos shtegu i biçikletave dhe trotuari sepse në shumë vende kalon nëpër prona private. Puseta ku sipas projektit është parapa kyçja e kanalizimit ka qenë pusët e instalimeve të KEDS-it. Për këtë arsye është dashur që të kyçen 20m përtej vendit të paraparë ku si pasojë është rritur gjatësia e gypit të kanalizimit fekal 630mm. Sipas planit të menaxhimit të

kontratës projekti duhej të përfundonte deri më gjysmën e muajit gusht 2021, ndërsa projekti nuk ka përfunduar deri në kohën e auditimit (mars 2022).

Pagesa në vlerë prej 50,000€ për “Ndërtimi i Urave”, po ashtu emërtimi i kontratës ishte “Ndërtimi i Urave”, gjatë ekzaminimit fizik kemi identifikuar se në lagjen Kolovicë rruga Osumi ishte ndërtuar muri mbrojtës nga rruga.

Përveç shkaqeve që janë identifikuar më lartë, kjo ka ndodhur edhe për shkak të planifikimeve jo adekuate nga njësit kërkuese si dhe monitorimit të dobët në menaxhimin e kontratave.

Ndikimi

Nënshkrimi i kontratave për punë pa zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe aspekteve tjera ka ndikuar në ngecjen e implementimit të projekteve kapitale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësisë kërkuese dhe zyrës së prokurimit se paramasa dhe paralogaria përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performances të punëve të kërkuara, të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat sipas projektit, si dhe në raste kur kërkohet, problemet pronësore dhe lejet e nevojshme për punimet që do të ekzekutohen të zgjidhen para nënshkrimit të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategoritë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve si dhe investimeve kapitale:

Çështja A12 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore / përbarimore

Gjetja Neni 39 i LMFPF, përcakton që Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i OB është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPF, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përbaruesi.

Si pasojë e pagesave me vendime gjyqësore / përbarimore, Komuna e Prishtinës ka paguar në emër të kamatave dhe procedurave të përbarimit vlerën prej 836,034€. Në total pagesat përfshirë borxhin dhe kamatat ishin 2,322,549€, ku për paga e mëditje janë paguar 697,691€, për mallra e shërbime 415,748€, shërbime komunale 1,837€, dhe investimeve kapitale 1,207,274€. Gjithashtu, gjatë auditimit të lëndëve kemi gjetur se shtatë (7) pagesa në vlerë totale 257,730€, nuk janë kryer brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve, por me vonesë nga tetë (8) deri 126 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuat në ekzekutim të pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, vonesave në kompletim të lëndëve, paqartësisë ligjore për pagesën e pagave shtesë/jubilare etj.

Ndikimi Pagesat përfshirë shpenzimet tjera përcjellëse të përbarimit ka shkaktuar kosto shtesë duke e dëmtuar buxhetin e komunës.

Rekomandimi A12 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë dhe sigurojnë se kontratat publike për punë, furnizime dhe shërbime po realizohen sipas kushteve kontraktuale përfshirë edhe pagesat përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 2,484,047,272€, e pasurive jokapitale është 1,063,404€, dhe e stoqeve 1,017,413€.

Çështja B8 - Mos përdorimi i programit e-pasuria dhe mos inventarizimi i pasurisë

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare, neni 6, pika 3, përcakton që pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen nga programi-pasuria. Ndërsa, me nenin 18, kërkohet që OB duhet të kontrollojnë së paku një herë në vit pasurinë për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jofinanciare.

Programi e-pasuria nuk përdoret për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe stoqeve. Shënimet financiare për pasuritë jokapitale dhe stoqet mbahen në formatin excel. Kjo formë e regjistrimit të pasurisë nuk ofron siguri për plotësinë e shënimeve, mund të bëhen gabime apo edhe ndryshime të paautorizuara. Si rezultat të dhënat e pasurisë të prezantuara në këtë format nuk mund të konsiderohen të plota dhe të sakta.

Komuna nuk ka caktuar as komision për inventarizimin vjetor të pasurisë publike dhe as komision për vlerësim të pasurisë, përveç disa iniciativave individuale që kanë ndërmarrë disa njësi komunale për inventarizim të pjesshëm të pasurisë. Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Mos inventarizimi i pasurisë përveç ndikimit që mund të ketë në shpaltosjen e pasaktë në pasqyrat financiare, po ashtu rrezikon mirëmbajtjen, humbjen dhe përvetësimin e pasurisë jo financiare.

Sipas shpjegimeve të zyrtarëve komunal, kjo ka ndodhë për shkak të problemeve teknike në funksionimin e këtij programi, si dhe mos formimit të komisioni për inventarizim.

Ndikimi Mosfunksionimi i sistemit e-pasuria pamundëson menaxhimin dhe kontrollin efektiv të pasurisë jokapitale. Mbjtja e evidencave manuale të të dhënave paraqet rrezik për lëshimin e gabimeve, ndërsa mos inventarizimi i pasurisë krijon mundësi të keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria. Të ndërmerren veprimet e nevojshme në futjen në përdorim të këtij aplikacioni për menaxhimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë të kryhet para përfundimit të vitit fiskal, me qëllim që të gjitha ndryshimet në vlerën e pasurisë të reflektojnë në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Të arkëtueshmet

Komuna e Prishtinës në PFV e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LI/A) në vlerë prej totale 63,970,441€. Mbi 50% e saldosh të llogarive të arkëtueshme përbehet nga tatimi në pronë, dhe pjesa tjetër nga taksat e ndërtimit, taksa të infrastrukturës, shpronësimeve, taksat e higjienës, taksa në lejet e biznesit dhe qiratë nga pronat publike.

Çështja B9 - Menaxhim i dobët i llogarive të arkëtueshme

- Gjetja** Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.
- Komuna nuk ka arritë të menaxhojë si duhet llogaritë e arkëtueshme. Komuna ka prezantuar në raportin financiar për vitin 2021 LI/A në vlerë totale 63,970,441€, ku më shumë se gjysma e tyre ka të bëjë me tatimin në pronë. Ndonëse në krahasim me vitin e kaluar vërehet një përmirësim i lehtë ku kemi rënie të LI/A për 2,553,658€, edhe më tutje saldoja aktuale konsiderohet materialisht e lartë dhe që po përcillet ndër vite. Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme në inkasimin me kohë të të hyrave nga tatimpaguesit.
- Mungesa e kontrolleve adekuate në menaxhim dhe inkasim të të hyrave ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme.
- Ndikimi** Mos inkasimi i LI/A reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Njëkohësisht kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.
- Rekomandimi B9** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Prishtinës ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me pesë auditorë. Komiteti i Auditimit për vitin 2021 kishte mbajtur pesë takime pune. NjAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit dhe nga dhjetë (10) auditime të planifikuara ka realizuar nëntë (9) auditime të brendshme, si dhe një (1) me kërkesë të menaxhmentit.

Çështja A13 - Mungesa e planeve të veprimit dhe nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve

Gjetja Me Rregulloren, procedurat dhe doracakun e auditimit të brendshëm kërkohet nga menaxhmenti që të dorëzojnë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Përgjigjet e menaxhmentit duhet të përfshijnë veprimet specifike që duhet të ndërmerren, personin(nat) përgjegjës për veprimet korigjuese, orarin dhe kryerjen e tyre dhe rezultatet e pritura.

Nga dhjetë (10) raporte të auditimit të brendshëm, vetëm tri (3) drejtorit⁶ kanë përgatitur planet e veprimit për adresim të rekomandimeve. NjAB në raportet e auditimit të brendshëm kishte dhënë 70 rekomandime, dhe nga to ishin zbatuar vetëm 21 apo 30% e tyre, ndërsa 37 rekomandime nuk ishin adresuar fare dhe 12 tjera ishin në proces të zbatimit.

Shkak i kësaj është mungesa e përkushtimit të menaxhmentit dhe njërive të audituara në adresimin dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Mungesa e planeve të veprimit dhe zbatimi i ulët i rekomandimeve ndikojnë negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi A13 Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë e audituara përgatitin planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së, dhe ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	85,792,836	118,612,785	80,290,988	72,916,837	78,648,130
Grante Qeveritare - Buxheti	57,520,889	54,911,980	51,494,467	51,368,532	51,327,902
Financimi përmes huamarrjes	0	989,067	857,737	1,308,768	18,063
Të bartura nga viti i kaluar	0	34,347,176	17,139,524	11,450,252	13,212,060
Të hyrat vetanake	28,271,947	28,271,947	10,729,366	8,709,543	14,073,880
Donacionet vendore	0	2,146	0	0	6,766
Donacionet e jashtme	0	90,469	69,893	79,742	9,458

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 32,819,949€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak në vlerë 34,347,176€ të dedikuara për investime kapitale dhe subvencione, rritje e buxhetit për paga për 291,000€, financimet nga huamarrjet në vlerë 989,067€ të dedikuara për paga e mëditje, mallra e shërbime për sektorin e shëndetësisë, dhe investime kapitale për arsimin fillor. Gjithashtu, kishte rritje të buxhetit nga donacionet në vlerë prej 93,000€ të dedikuar për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime. Ndërsa, zvogëlim të buxhetit sipas LMFPP për investime kapitale kishte në vlerë 2,900,000€.

Në vitin 2021 Komuna e Prishtinës ka shpenzuar 68% të buxhetit përfundimtar ose 80,290,988€, me një përmirësim prej 7% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	85,792,836	118,612,785	80,290,988	72,916,837	78,648,130
Pagat dhe mëditjet	31,000,000	31,449,882	31,448,161	30,893,485	30,008,503
Mallrat dhe shërbimet	20,100,000	20,907,567	19,474,911	18,711,442	15,594,153
Komunalitë	2,100,000	2,100,000	1,987,860	1,829,705	2,351,819
Subvencionet dhe transferet	4,000,000	10,724,000	9,969,735	5,061,086	11,847,911
Investimet Kapitale	26,312,837	51,151,336	17,410,321	16,421,119	18,845,745
Rezervat	2,280,000	2,280,000	0	0	0


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me buxhetin fillestar është rritur për 449,882€. Buxheti shtesë është dedikuar për shërbimet e kujdesit primar shëndetësor në vlerë 158,802€, kjo nga fondi i huamarrjes, dhe 291,080€ përmes ndryshimeve nga vendimet e Qeverisë.
 - Buxheti final për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në raport me buxhetin fillestar është rritur për 807,567€. Buxheti shtesë është dedikuar për shërbimet e kujdesit primar shëndetësor dhe arsimin fillorë në vlerë 802,119€, kjo nga fondi i huamarrjes, dhe 5,448€ nga donacionet.
 - Rritja e buxhetit final në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve është ndikuar nga të hyrat e bartura të vitit 2020 në vlerë 6,724,000€.
 - Buxheti final për kategorinë e investimeve kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 24,838,499€. Nga buxheti shtesë, 28,146€ janë dedikuar për arsimin fillorë nga fondi i huamarrjes, 87,167€ janë dedikuar për arsimin fillor dhe infrastrukturën publike nga fondi i donacioneve, 27,623,176€ nga të hyrat e bartura të vitit paraprak, si dhe prej shkurtimeve buxhetore për 2,899,990€ nga programi i shërbimeve publike dhe programi i investimeve kapitale dhe menaxhimit të kontratave. Programi i Investimeve Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe 27 projekte të reja për vitin aktual.
- Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 34% e buxhetit ishte shpenzuar. Shpenzimi i ulët domethënës kundrejt rritjes së buxhetit në këtë kategori është për shkak të fillimit të projekteve pa i zgjidhur çështjet pronëso-ro-juridike, vonesat në iniciimin e procedurave të prokurimit, ankesat në OSHP, si dhe vonesa në realizimin e punimeve.

Bazuar në Ligjin e buxhetit, komuna kishte pasur në dispozicion fonde në vlerë prej 2,280,000€ për kategorinë e Rezervës”, që me vendim të Ministrit mund të bartet tek kategoria e pagave dhe shtesave, në varësi nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 06/ L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Këto fonde nuk janë shpenzuar në vitin 2021.

Shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe rimëkëmbje ekonomike ishin në vlerë prej 1,305,315€ dhe kjo shumë është shfrytëzuar për paga e mëditje.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës ishin në vlerë 35,436,252€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për lejet e ndërtimit, shfrytëzimi i pronës publike, taksat administrative, participimet, taksat për ushtrimin e veprimtarisë, të hyrat nga qiraja etj. Për vitin 2021, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë totale 28,271,947€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i realizimit të të hyrave të këtij viti është rritur rreth 42%, apo për 10,465,387€. Rritja kryesisht ka të bëjë me tatimin në pronë dhe taksat nga lejet ndërtimore.

Gjithashtu, në vitin 2021 komuna ka realizuar të hyra nga gjobat në trafik në vlerë 2,648,747€, të hyra nga gjykatat prej gjobave në vlerë 82,030€, si dhe nga Agjencia e Pyjeve të hyra në vlerë 4,296€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	28,271,947	28,271,947	35,436,252	24,963,214	28,891,067
Të hyrat tatimore	7,775,089	7,775,089	10,659,137	6,220,483	7,601,297
Të hyrat jo tatimore	20,496,858	20,496,858	24,769,464	18,615,901	21,288,809
Të hyrat tjera	0	0	7,651	126,830	961

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar me 15 rekomandime kryesore. Komuna e Prishtinës kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2020 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar dhe nëntë (9) rekomandime nuk janë adresuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të merren të gjitha veprimet e nevojshme në bashkëpunim me Ministrin e linjës për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria.	Nuk janë ndërmarra veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të monitoroj se procesi i inspektimit/verifikimit të pronave bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu duhet të siguroj se politikat e komunikimit me palët e interesit/tatimpaguesit janë duke funksionuar me qëllim të azhurnimit të bazës me të dhëna të sakta sa i përket aplikimit/mos aplikimit të zbritjeve të lejuar sipas kërkesave ligjore.	Nuk janë ndërmarra veprime.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se zyrat përgjegjëse kanë staf të mjaftueshëm në dispozicion dhe shqyrtimi i kërkesave për leje mjedisore dhe atyre ndërtimore bëhet brenda afateve të përcaktuara me ligj. Në të kundërtën duhet të shqyrtohet mundësia e angazhimit të kuadrove shtesë në këto departamente.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Të hyrat	Kryetari, duhet ti përmbahet zotimeve sipas planit të veprimit të përgatitur nga vet Komuna që çështja e këtyre pronave të zgjidhet duke përdorur të gjitha mundësit ligjore për menaxhimin e këtyre pronave. Të siguroj se pronat komunale do të ofrohen në shfrytëzim nëpërmes një procesi transparent që do të rezultojë me kontrata valide, dhe Komunës si titullar i pronës publike duhet ti sjellin përfitime maksimale.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Kryetari duhet të sigurojë që të mos realizohen pagesa pa kontratë publike. Lëndët të kompletohen me dokumentacionin e nevojshëm para se ato të dërgohen për pagesë. Pranimi i mallrave dhe shërbimeve të bëhet nga zyrtarët e autorizuar për menaxhim dhe mbikëqyrje të kontratave.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Kryetari duhet të sigurojë se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret në rrethana të arsyeshme sipas LPP, duke eliminuar mundësinë e diskriminimit të operatoreve. Për shërbimet e sigurimit, me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës të negociojë termet e kontratës me më shumë operator ekonomik që në treg ofrojnë shërbimin e njëjtë.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë një proces të rregullt dhe të besueshëm të vlerësimeve të dëmeve për kulturat bujqësore, dhe të shtoj masat e kontrollit gjatë fazës së vlerësimit të kërkesave. Po ashtu të rrisë mbikëqyrjen e projekteve të financuara nga subvencionet dhe në raste të mos realizimit të projekteve komuna duhet të ndërmarrë masat për shkëputje të kontratës.	Janë janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-te, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se po zbatohen rregullat e vendosura të prokurimit sa i përket ndarjes së duhur të detyrave, duke eliminuar mundësinë e angazhimit të zyrtarëve të njëjtë në detyra të cilat kanë konflikt interesi.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit si dhe menaxherëve të kontratave se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuar të aplikohen masat e parapara në kontratë.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroje se kontrollet e vendosura tek mbikëqyrja e projekteve kapitale janë funksionale. Po ashtu, të sigurojë që për menaxhim të kontratave të autorizohen personat e përgjegjshëm dhe kompetent, që sigurojnë se punët mbikëqyren dhe pranohen sipas kushteve të kontratës.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit pranon garancionin pas përfundimit të projektit, me afat të vlefshëm sikurse është përcaktuar në kontratë. Gjithashtu të siguroj se organi mbikëqyrës respekton vendimin dhe zbaton kontrollet duke marr përgjegjësi për mbikëqyrje të projektit dhe duke nënshkruar raportin e pranimit. Në raste të caktuara mund të bëhet zëvendësimi i tyre me vendime të reja.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
13.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se zotimi i fondeve bëhet para hyrjes në obligime kontraktuale dhe urdhri për blerje duhet ti paraprijë furnizimit të mallrave apo shërbimeve me qëllim të funksionimit të kontrollit në realizimin e kontratave.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë përgatit me kohë raportin për inventarizimin e pasurive apo para datës së përgatitjes së PFV-ve.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për arkëtimin e borxheve duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion si dhe të ndërmarr masa ligjore për ti mbledhur këto llogari, të cilat do të shfrytëzohen për arritjen e objektivave të planifikuar nga këto fonde.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës , për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Perparim Rama

(Kryetar i Kryeqytetit),

Data: 07.06.2022, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Dy mësimdhënëse për mësim klasor, një mësimdhënëse për gjuhë shqipe dhe një edukatore për parafillor.
- ⁵ Tri mostrat kanë të bëjnë me një punonjës në zyrën e prokurimit, një punonjës në zyrën e personelit dhe një punonjës në zyrën e inspektionit.
- ⁶ Drejtorit që kanë përgatitur planin e veprimtimit janë Drejtoria e parqeve, Drejtoria e investimeve kapitale dhe menaxhim të kontratave dhe Drejtoria për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.